



KOMUNA E MALISHEVËS



BULETINI

Nr. 151 – Qershor – 2016 – Zyra për Informim Publik - <https://kk.rks-gov.net/malisheve/>



Pamje gjatë përrurimit të memorialit për UÇK dhe përrurimi i rrugëve, me rastin e 16 Qershorit, Ditës së Çlirimit dhe të Dëshmorëve të Malishevës



Përmbajtja:

Shënohet 1 Qershori-Dita e Fëmijëve.....	3
Filloi asfaltimi i rrugës Marali-Gajrak	3
Maturantët malishevas, trajnohen për orientim në karrierë	4
Binjakëzohen shkollat e Malishevës dhe Paskuqanit.....	5
Situata epidemiologjike nën kontroll, ndërsa vazhdojnë me sukses fushatat e dezinfektimit dhe repelimit.....	6
Kryetari Begaj, priti futbollistin Vesel Limaj.....	7
Vazhdon realizimi i disa projekteve në qytetin e Malishevës.....	8
KK i Malishevës, miratoi propozimet për ndarjen e çmimeve tradicionale për 16 Qershorin	8
Malisheva përgatitet për shënimin e 16 Qershorit.....	9
Zbulohet busti i dëshmorit Salih Bytyçi.....	10
Çdo gjë gati për shënimin e 16 Qershorit në Malishevë.....	11
Në prag të 16 Qershorit, filluan të realizohen disa projekte në Malishevë.....	11
Përfunduan turneu në futsall dhe ora letrare.....	12
Kampioni Dardan Morina, i pari uroi Begajn për 16 Qershor	13
Malisheva po shënon 16 Qershorin	14
Filloi asfaltimi i rrugës në lagjen e Hotëve	18
KPF shqyrtoi kornizën afatmesme buxhetore 2017-2019	19
Filloi rregullimi edhe i një rruge në Malishevë	20
Inspektorati kontrollon marketet për afat të skadimit të gjërave ushqimore	20
Humanisti Kryeziu, investoi në rregullimin e ujit për QMF-në në Pagarushë.....	21
Komuna e gatshme për fushatën e korrje shirjeve.....	22
Malisheva vazhdon të mbetet komunë e sigurt	23
Ministria e Diasporës dhe Komuna e Malishevës, bëjnë thirrje për regjistrimin e bashkatdhetarëve ..	24
KK i Malishevës, miratoi Kornizën Afatemesme Buxhetore	25



Shënohet 1 Qershori-Dita e Fëmijëve

Malishevë, 1 qershor



Sot, me aktivitete të ndryshme, të organizuara nga drejtoria komunale për arsim dhe edukim dhe ajo për kulturë, rini dhe sport, po shënohet 1 Qershori-Dita Ndërkombëtare e Fëmijëve. Aktivitetet e sotme, me të cilat po shënohet kjo ditë, kanë filluar me vizita të fëmijëve në institucione, për të vazhduar me gara në vrapim, e më pas me program për fëmijë në parkun e qytetit në Malishevë.

Fillimisht, fëmijët parashkollorë të shkollës “Ganimet Tërbeshi” nga Astrazupi, kanë vizituar Komunën e Malishevës, ku janë takuar me nënkryetarin Rexhep Mazreku dhe drejtorin e arsimit, Avdi Morina, të cilët edhe i kanë uruar fëmijët me rastin e 1 Qershorit. Më pas këta fëmijë, kanë vizituar edhe muzeun e qytetit në Malishevë.

Pas kësaj vizite, është mbajtur vrapimi për fëmijë, ku morën pjesë mbi pesëdhjetë fëmijë. Ky kros do të jetë tradicional.

Aktivitetet kanë vazhduar me një program kulturor-argëtues për fëmijë. Ky program ka filluar paraqitjen e fëmijëve të çerdhes, për të vazhduar me fëmijë nga shkollat e Komunës së Malishevës. Fillimisht, të gjithë fëmijët i ka uruar drejtori i Drejtorisë për Arsim dhe Edukim, Avdi Morina.

Filloi asfaltimi i rrugës Marali-Gajrak

Malishevë, 1 qershor

Në kuadër të rregullimit të infrastrukturës rrugore në Komunën e Malishevës, dhe në kuadër të lidhjes së fshatrave mes vete, përmes rrugëve, sot ka filluar të asfaltohet edhe rruga që lidhë



fshatrat Marali dhe Gajrak. Asfaltimin e kësaj rruge, e kanë përcjellë nga afër edhe nënkryetari i Komunës së Malishevës, Rexhep Mazreku dhe drejtori i urbanizimit, Ahmet Morina.



“Kjo rrugë është shumë e rëndësishme për juve dy fshatrat, Marali dhe Gajrak, pasi nga tani, rruga mes juve është shkurtuar për më shumë se katër kilometra, ku në vend të gjashtë kilometrave, tani ju i bëni më pak se dy kilometra, për të shkuar nga njëri fshat në tjetrin”, tha me këtë rast nënkryetari Mazreku, i cili i uroi banorët e dy fshatrave për rrugën e re. “Kjo rrugë gjithashtu, ka rëndësi të veçantë, pasi ka qenë njëra prej rrugëve ë është shfrytëzuar nga UÇK-ja dhe ka edhe

rëndësi historike, prandaj ka qenë obligim i dyfishtë i yni, që ta zgjerojmë dhe asfaltojmë këtë rrugë”, tha Mazreku.

Ndërsa drejtori Morina, tha se “rruga është duke u asfaltuar sipas planifikimeve tona dhe me cilësi”. Morina, tha s kjo “rrugë është e gjatë 1.8 kilometra dhe e tëra financohet nga buxheti komunal i Malishevës, ndërsa si drejtori, jemi të përkushtuar në rregullimin e infrastrukturës së përgjithshme dhe në realizimin e projekteve të planifikuara për këtë vit”.

Maturantët malishevas, trajnohen për orientim në karrierë

Malishevë, 1 qershor

Organizuar nga Kuvendi i të Rinjve të Malishevës dhe të përkrahur nga Komuna e Malishevës, sot është mbajtur trajnimi për maturant, me temën “Orientimi në karrierë”. Qëllimi i këtij trajnimi, ishte këshillimi i të rinjve, për orientimin e tyre në studimet universitare dhe zgjedhjen e profesionit të duhur për ta.

Trajnimi është mbajtur në ambientet e gjimnazit “Hamdi Berisha” në Malishevë, ndërsa ligjërues ishte prof.mr.sc.Avdyl Kastrati, ndërsa në hapje të këtij trajnimi mori pjesë edhe drejtori i arsimit në Malishevë, Avdi Morina, i cili gjithashtu ju dëshiroi suksese maturantëve malishevas, në zgjedhjet e tyre për studime në universitet dhe uroi të ata të zgjedhin profesionet më të mira të mundshme, në mënyrë që nesër të dalin profesionist nga drejtimet që ata zgjedhin.



Ndërsa ligjëruesi Avdyl Kastrati, lidhur me temën për orientimin në karrierë, tha se “zgjidhja e profesionit, përkatësisht orientimi në karrierë, është një ndër vendimet më të rëndësishme në jetë dhe se marrja e vendimit për profesionit e caktuar, është rezultat i një procesi të ndërlikuar dhe i ndikimit të shumë faktorëve”.

Ndërsa maturantët i uruar edhe kryetari i Kuvendit të të Rinjve të Malishevës, Lulzim Buzhala, si dhe e ka falënderuar të gjithë ata që kanë ndihmuar në realizmin e këtij trajnimi, duke filluar nga Komuna e Malishevës, ligjëruesin, drejtorinë e arsimit dhe gjimnazin “Hamdi Berisha” në Malishevë.

Binjakëzohen shkollat e Malishevës dhe Paskuqanit

Malishevë, 2 qershor

Sot në Malishevë, me rastin e shënimit të ditës së shkollës fillore dhe të mesme të ulët “Ibrahim Mazrreku” në Malishevë, kjo



shkollë, është binjakëzuar me shkollën nëntëvjeçare “Tahir Sinani” nga Paskuqani, Komuna e Kamzës në Shqipëri. Në këtë ceremoni morën pjesë edhe nënkryetari i Komunës së Malishevës, Rexhep Mazreku, drejtorët respektiv të arsimit në Malishevë dhe Kamëz, Avdi Morina dhe Ermioni Cekani dhe drejtoritë e arsimtarët të dy shkollave.

Me këtë rast, nënkryetari Mazreku, duke shprehur kënaqësinë e tij për këtë binjakëzim, i uroi të dy shkollat si dhe uroi që bashkëpunimi të zgjerohet edhe në fushat tjera në mes institucioneve në Kosovë dhe Shqipëri.

Ndërsa drejtori Morina e vlerësoi një ngjarje me rëndësi, këtë binjakëzim, duke e lidhur me dy figurat madhore të luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, Ibrahim Mazrrekut dhe Tahir



Sinanit, emrat e të cilëve i mbajnë këto dy shkolla. Edhe drejtoresha për arsim në Kamëz, Ermioni Cekani, shprehi kënaqësinë për këtë binjakëzim dhe tha se “falë këtij binjakëzimi, nxënësit tanë do të mësojnë më shumë historinë dhe figurat e ndritura të kombit, të dy heronjve tanë, Ibrahim Mazrekut dhe Tahir Sinanit”.

Ky binjakëzim, është nënshkruar nga ana e drejtorëve të dy shkollave, përkatësisht drejtorit Januz Mazrekut dhe Thanas Anastasit.

Po ashtu, sot nënkryetari Mazreku, sot ka vizituar edhe familjen dëshmorit të kombit Visar Krasniqi, pastaj ka bërë homazhe dhe nderime tek busti i dëshmorit Kujtim Krasniqi, si dha janë bërë homazhe, në Kleçkë dhe në vendin e rënies së dëshmorëve të kombit të rënë, me 2 qershor, përkatësisht dëshmorëve Ibrahim Mazreku, Kujtim Krasniqi, Ejup Kryeziu e Milaim Beha.

Situata epidemiologjike nën kontroll, ndërsa vazhdojnë me sukses fushatat e dezinfektimit dhe repelimit

Malishevë, 6 qershor

“Situata epidemiologjike me ethet hemorragjike, është nën kontroll dhe nuk ka asnjë rast të regjistruar me EHKK”, kështu u raportua në mbledhjen e rregullt të Këshillit të Drejtorëve, të mbajtur nga Kryetari i Komunës së Malishevës, Ragip Begaj. Në këtë mbledhje i shpreh shqetësimi për digën në liqenin e Mirushës, pasi është dëmtuar jashtë mase dhe u kërkua zgjidhje e shpejtë për këtë çështje.

Drejtori për shëndetësi, Hajdin Berisha, duke raportuar për gjendjen epidemiologjike në Komunën e Malishevës, tha se “situata është nën kontroll dhe pavarësisht rasteve të thumbimeve nga rriqrat, nuk ka asnjë rast të infektuar”. Berisha, po ashtu, bëri të ditur, se po vazhdon me sukses faza e tretë e repelimit të kafshëve dhe faza e dytë e dezinfektimit selektiv.

Ndërsa drejtori i shërbimeve publike, Milazim Morina dhe drejtori për mbrojtje dhe shpëtim, Sejdi Paçarizi, kanë ripërsëritur shqetësimin e tyre, për gjendjen e digës, në liqenin Mirusha, ku sipas tyre, ose duhet të intervenohet urgjentisht, ose të shterohet gradualisht liqeni, pasi vërshimet e dimrit, e kanë dëmtuar jashtë masë digën dhe ekziston rreziku për qarje më të mëdha në digë, që mund të jenë me pasoja, për të gjithë ata që jetojnë përgjatë lumit, sidomos në fshatin Mirushë.



Në mbledhjen e sotme, drejtori i arsimit, Avdi Morina, tha se “testi i maturës, është mbajtur pa asnjë problem në Malishevë, si dhe garat republikane në volejboll për shkolla’.

Po ashtu në këtë mbledhje, drejtoresha për kulturë, rini dhe sport, Blerta Krasniqi, tha se “po vazhdojnë përgatitjet për shënimin e 16 Qershorit, ndërsa kanë filluar procedurat për konkursin artistik, si dhe për mbajtjen e garave sportive, tradicionale, në futboll, volejboll dhe shah”.

Në fushën e bujqësisë, drejtori Haxhi Krasniqi, bëri të ditur se ka përfunduar projekti për ndërtimin e serrave, ndërsa janë në procedurë për projektin e shtallave për fermerë, pjesë e investimeve komunale në bujqësi.

Kryetari Begaj, priti futbollistin Vesel Limaj

Malishevë, 7 qershor



Kryetari i Komunës së Malishevës, Ragip Begaj, në kuadër të takimeve të tij, me bashkatdhetarët tanë, të cilët janë të njohur me sukseset e tyre në sport, sot e ka pritur në zyrën tij, futbollist e FC “Hamburg” - U23, Vesel Limaj, i cili është reprezentues i Kosovës U21, pasi ka pranuar ftesën e Federatës Kosovare të Futbollit. Kryetari Begaj, i ka uruar suksese futbollistit Limaj.

Vesel Limaj, cilësohet si njëri pres super talenteve të ekipit të Hamburgut, në Gjermani dhe pas pranimit të Kosovës në UEFA dhe FIFA, përfaqësuesja e Kosovës në futboll U21, i ka bërë ftesë Limajt, ndërsa ky i fundit e ka pranuar ftesën dhe tani edhe zyrtarisht është pjesë e reprezentacionit të Kosovës.



Vazhdon realizimi i disa projekteve në qytetin e Malishevës

Malishevë, 8 qershor



Krahas investimeve në vendbanimet e Komunës së Malishevës, edhe në lagjet e qytetit, janë duke u realizuar disa projekte për rëndësi për këto lagje dhe për vet qytetin. Pas përfundimit të kanalizimit në lagjen e Hotëve, sot ka filluar rregullimi i kanalizimit në lagjen e Gurit, përdërisa po vazhdojnë punimet në hapjen dhe rregullimin e një rruge në lagjen e Hotëve, e cila do të shërbejë edhe një mini transit për qytetin.

Realizimin e këtyre projekteve, e ka parë nga afër edhe i pari i Malishevës, Ragip Begaj dhe drejtori i urbanizimit Ahmet Morina, të cilët i kanë inspektuar punimet në këto dy lagje.

“Rregullimi i infrastrukturës brenda qytetit, është një prej prioriteteve të qeverisë komunale, pasi Malisheva, çdo ditë e më tepër po e merr pamjen e një qyteti të urbanizuar dhe me infrastrukturë të kompletuar”, tha kryetari Begaj.

“Deri në fund të vitit parashihen edhe investime tjera me rëndësi për qytetin, në veçanti në zgjerimin dhe rregullimin e rrugës “Rilindja Kombëtare”, pastaj rregullimi i derdhjes së ujërave atmosferik në lagjen e Gurit si dhe një asfaltimi i rruge tjetër në këtë lagje dhe shumë projekte tjera”, ka deklaruar drejtori i urbanizimit Ahmet Morina.

KK i Malishevës, miratoi propozimet për ndarjen e çmimeve tradicionale për 16 Qershorin

Malishevë, 9 qershor

Kuvendi i Komunës së Malishevës, ka vazhduar punimet e mbledhjes së pestë, ku anëtarët e KK-së, me shumicë të votave kanë miratuar propozimet e Këshillit Organizativ për shënimin e 16 Qershorit-Ditës së Çlirimit dhe Ditës së Dëshmorëve të Komunës së Malishevës, për ndarjen e çmimeve tradicionale “Imer Krasniqi”-për trimëri dhe heroizëm, çmimin “Hamdi Berisha”-për



kontribut në shollën shqipe dhe çmimin “Dr.Shpëtim Robaj”-për kontribut në shëndetësi. Fituesit çmimet do ti marrin më 16 Qershor, me rastin e shënimit të Ditës së Çlirimit dhe Ditës së Dëshmorëve. Propozimet e Këshillit Organizativ, i ka prezantuar Kryetari i Komunës së Malishevës, Ragip Begaj.

Përndryshe, pas miratimit të kësaj pike, anëtarët e kuvendit nga radhët e PDK-së, sërish kanë bllokuar foltoren në sallën në mbledhjeve, e më pas duke krijuar edhe zhurmë, për ta pamundësuar vazhdimin e mbledhjes së pestë, në shenjë pakënaqësie, për mos vendosjen e fotografisë së Presidentit të vendit.

Duke e vlerësuar situatën e krijuar, dhe me qëllim të evitimit të situatave të pakëndshme, kryesuesi i Kuvendit të Komunës së Malishevës, Aziz Thaçi, ka ndërprerë vazhdimin e seancës.

Për të njëjtën çështje, mbledhja e pestë e rregullt e KK të Malishevës, ishte ndërprerë edhe me datën 27 maj 2016.

Për vazhdimin e seancës, kryesuesi i KK-së, Aziz Thaçi, do ti njoftoj anëtarët e kuvendit me kohë.

Malisheva përgatitet për shënimin e 16 Qershorit

Malishevë, 13 qershor

Komuna e Malishevës, tashmë është në fazën përfundimtare të përgatitjeve për shënimin e 16 Qershorit-Ditës së Çlirimit dhe Ditës së Dëshmorëve. Në mbledhjen e rregullt të Këshillit të Drejtorëve, të gjitha drejtoritë, aktivitetet e të cilave lidhen me shënimin e kësaj date, thanë se janë të përgatitura për organizimin e 16 Qershorit.

Në mbledhjen e sotme, edhe Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport, si bartëse e shumicës së aktiviteteve, raportuan për përgatitjet, të cilat tashmë janë të fazës finale, përfshi edhe agjendën, ku përveç aktiviteteve tradicionale, do t ketë edhe përuhim të projekteve të ndryshme, si dhe përuhimin i memorialit për UÇK-në.

Po ashtu në mbledhjen e sotme, u raportua edhe për aktivitete tjera të drejtorive, ku u tha se janë duke vazhduar me realizimin e projekteve sipas planifikimeve, pastaj spërkatja e zonave endemike, kundër rriqrave dhe repelimi i kafshëve, po ashtu është duke u realizuar pa probleme.



Ndërsa sipas drejtorisë për buxhet dhe financa, është duke u hartuar qarkorja e parë buxhetore, ndërsa në ditët në vijim, me qëllim të hartimit sa më të mirë të projekt buxhetit, u tha se përveç debateve të obliguara publike, do të organizohen takime në fshatra, për ti marrë prioritetet në bazë të nevojave të vendbanimeve, në mënyrë që buxheti i planifikuar për investime kapitale, të hartohet duke u bazuar në kërkesat e qytetarëve.

Zbulohet busti i dëshmorit Salih Bytyçi

Malishevë, 13 qershor



Në vigjilje të shënimit të Ditës së Çlirimit dhe Ditës së Dëshmorëve të Komunës së Malishevës, sot në fshatin Shkozë, përkatësisht në oborrin e shkollës që mban emrin e dëshmorit, u bë zbulimi i bustit të dëshmorit Salih Bytyçi nga fshati Shkozë i Malishevës. Zbulimin e bustit e bënë, djali i dëshmorit dhe i pari i Malishevës, Ragip Begaj.

Paraprakisht, u mbajtë edhe një akademi, kushtuar dëshmorit Salih Bytyçi, ku u fol për jetën dhe veprën e dëshmorit. Kryetari i Komunës së Malishevës, Ragip Begaj, duke folur me këtë rast, tha se “njerëzit si Salihu, ja rritën emrin vendit dhe ne ju jemi mirënjohës për jetë. Populli ynë, ka luftuar me gjenerata të tëra, deri në fitimin e lirisë dhe të gjithë ata që ranë për vendin, si Salihu, do të kujtohen përgjithmonë”.

Ndërsa deputetja e Kuvendit të Kosovës, Shukrije Bytyçi, tha se “lufta e UÇK-së, është krenaria më e madhe në historinë e kombit shqiptar”

Për jetën dhe veprën e dëshmorit Salih Bytyçi, foli Njazi Bytyçi, veteran i UÇK-së dhe bashkëluftëtar i Salihut, i cili në mënyrë kronologjike paraqiti jetën dhe veprimtarinë e Salihut, nga fëmijëria, shkollimi, puna si mësues, e deri në kycjen e tij në luftën e UÇK-së, ku edhe u vra më 2 prill të vitit 1999.



Çdo gjë gati për shënimin e 16 Qershorit në Malishevë

Malishevë, 14 qershor

Këshilli Organizativ për shënimin e 16 Qershorit - Ditës së Çlirimit dhe Ditës së Dëshmorëve të Komunës së Malishevës, i drejtuar nga kryetari Ragip Begaj, ka mbajtur sot mbledhjen e fundit të saj, në kuadër të përgatitjeve për shënimin e 16 Qershorit. Këshilli Organizativ, ka vlerësuar se çdo gjë është gati dhe se janë kryer të gjitha parapërgatitjet.

Fillimisht kryetari Begaj, i ka falënderuar të gjithë anëtarët e Këshillit Organizativ, për kontributin e tyre në përgatitjet për shënimin e kësaj dite të shenjtë për Malishevën, ndërsa më pas, drejtoresha për kulturë, rini dhe sport, Blerta Krasniqi, i ka njoftuar anëtarët e këshillit, me agjendën e dy ditëve për shënimin e 16 Qershorit.

Sipas Krasniqit, disa aktivitete sportive tashmë kanë përfunduar, ndërsa disa tjera janë në përfundim e sipër, ku më 15 qershor planifikohen të përfundojnë, ndërsa edhe disa aktivitete kulturore, do të përfundojnë po më 15 qershor, kurse pjesa tjetër, e aktiviteteve tradicionale, do të mbahen më 16 qershor.

Këtë agjendë të cilën e ka miratuar edhe Këshilli Organizativ, më 16 qershor, aktivitetet do të fillojnë me mbledhjen solemne të Kuvendit të Komunës, për vazhduar me homazhe dhe nderime, pastaj tubimi qendror, kurse gjatë tërë ditës do të ketë edhe përrurime të projekteve, kryesisht infrastrukturë rrugore, si dhe zbulimi i memorialit kushtuar UÇK-së, si dhe në fund do të mbahet një koncert në parkun e qytetit.

Në prag të 16 Qershorit, filluan të realizohen disa projekte në Malishevë



Malishevë, 15 qershor

Në vigjilje të 16 Qershorit, Ditës së Çlirimit dhe Ditës së Dëshmorëve të Komunës së Malishevës, kanë filluar punimet në realizimin e dy projekteve me rëndësi, si dhe një projekt ka përfunduar. Po ashtu gjatë ditës së sotme, po shënohen edhe një varg aktiviteteve, siç janë përkujtime dhe shënime të ditëve të shkollave,



aktivitete sportive dhe kulturore-artistike.

Sot, kanë vazhduar punimet në implementimin e njërit prej projekteve më madhore, që ka të bëjë me ujin për pije. Në fshatin Senik, kanë vazhduar punimet për ndërtimin e ujësjellësit, prej ku do të furnizohen 13 fshatra të Komunës së Malishevës. Vazhdimi i realizimit të këtij projekti, financohet nga qeveria zvicerane, dhe implementohet në bashkëpunim me “Hidroregjionin Jugor” dhe Komunën e Malishevës. Në vazhdimin e implementimit të këtij projekti, mori pjesë edhe nënkryetari i Komunës së Malishevës, Rexhep Mazreku dhe drejtori i urbanizimit, Ahmet Morina.

Po ashtu sot, ka filluar ndërtimi i një fabrike për riciklimin dhe asgjësimin e mbeturinave. Në këtë ceremoni, mori pjesë edhe kryetari i Komunës së Malishevës, Ragip Begaj me bashkëpunëtorë. Kryetari Begaj, e uroi kompaninë “Princ”, për fillimin e punimeve, ndërsa përfaqësuesit e kësaj kompanie, thanë se “këtu do të bëhet riciklimi dhe asgjësimi i mbeturinave, sipas standardeve ndërkombëtare, pa ndotje në ambient”.

Edhe në çerdhen e fëmijëve, ka përfunduar ndërtimi i rrethojës së çerdhes dhe rregullimi i oborrit të saj.

Kurse në fshatin Carrallukë, përkatësisht në SHFMU “Imer Krasniqi”, është mbajtur dita e kësaj shkolle, e cila mbanë emrin e dëshmorit të parë të Komunës së Malishevës, Imer Krasniqi, i rënë më 16 qershor 1998. Në shënimin e kësaj dite, mori pjesë drejtori i arsimit, Avdi Morina, i cili i ka uruar mësuesit, nxënësit dhe banorët e Carrallukës, me rastin e shënimit të ditës së shkollës.

Ndërsa gjatë ditës së sotme, do të zhvillohen edhe finalet në turnirin e futbollit “Ibrahim Mazreku”, e që mbahet në kuadër të aktiviteteve sportive, me rastin e shënimit të 16 Qershorit, si dhe do të mbahet edhe një orë e madhe letrare, ku do të publikohen edhe rezultatet e konkursit artistik.

Përfunduan turneu në futsall dhe ora letrare

Malishevë, 15 qershor

Sot në Malishevë, ka përfunduar turneu në futsall “Ibrahim Mazreku”, që mbahet me rastin e Ditës së Çlirimit dhe Ditës së Dëshmorëve të Komunës së Malishevës, si dhe ora letrare, ku edhe



janë edhe çmimet e konkursit artistik. Po sot, janë shpërndarë edhe çmimet në garat e pingpongut, volejbollit dhe shahut, të gjitha këto aktivitete të organizuara, në kuadër të shënimit të 16 Qershorit.



Në futsall, në finale të këtij turneu, janë ndeshur KF “Yjet” me FC “Lirimi”, ndërsa më të mirë dolën ekipi “Yjet”, të cilët edhe morën kupën “Ibrahim Mazreku”. Në volejboll, vendin e parë e ka zënë ekipi nga Drenoci, në pingpong Nysret Kryeziu dhe në shah, Haki Kryeziu.

Në ceremoninë e ndarjes së shpërblimeve kanë marrë pjesë edhe kryetari i Komunës së

Malishevës, Ragip Begaj, i cili edhe ka ndarë shpërblimin në futsall, pastaj nënkryetari Rexhep Mazreku, drejtoresha për kulturë, rini dhe sport, Blerta Krasniqi dhe zyrtarë tjerë komunal.

Po ashtu, sot është mbajtur edhe një orë letrare, ku kanë marrë pjesë poet nga komuna të ndryshme të vendit, si dhe janë ndarë shpërblimet në konkursin artistik, përkatësisht në konkurrencën e poezisë. Në këtë konkurs, vendin e parë e parë e zuri poezia “Nga karroca”, e poetit Osman Bojaxhiu.

Kampioni Dardan Morina, i pari uroi Begajn për 16 Qershor



Malishevë, 16 qershor

Sot Malisheva po shënon 16 Qershorin, Ditën e Çlirimit dhe Ditën e Dëshmorëve, ndërsa kampioni i shumëfishtë botëror në kik-boks, Dardan Morina, ishte personi i parë që vizitoi kryetarin e Komunës së Malishevës, Ragip Begaj, për ti uruar me rastin e 16 Qershorit. Edhe kryetari Begaj, e uroi Morinën për mbrojtjen e titullit të kampionit.



“Unë shfrytëzoj rastin t’ju falënderoj juve për vizitën dhe urimet për 16 Qershor, si dhe t’ju falënderoj për përkrahjen e vazhdueshme që ju jepni për vendin, në veçanti për familjet në nevojë. Ne jemi krenar me ju”, tha kryetari Begaj.

Ndërsa kampioni Dardan Morina, e uroi kryetarin Begaj dhe të gjithë qytetarët e Komunës së Malishevës, me rastin e 16 Qershorit Ditës së Çlirimit dhe Ditës së Dëshmorëve.

Përndryshe, kampioni në kik-boks Dardan Morina, çdo vit viziton institucionin e komunës, pasi është me prejardhje nga Drenoci i Malishevës, e cili po ashtu njihet edhe aktivitetet e tij humanitare.

Malisheva po shënon 16 Qershorin

Malishevë, 16 qershor

Komuna e Malishevës, përmes aktiviteteve të ndryshme, po shënon 16 Qershorin – Ditën e



Dëshmorëve. Përveç mbledhjeve solemne, shënimi i kësaj date, është karakterizuar edhe me përrurime të tri rrugëve, ndërsa pas tubimit qendror, ku edhe ndahen çmimet tradicionale, është përruar memoriali i UÇK-së dhe është ngritur flamuri kombëtar, në majën e Goleshit, mbi qytetin e Malishevës, kurse të gjitha aktivitetet përfundojnë me një koncert të madh në parkun e qytetit.

Fillimisht, Kuvendi i Komunës së Malishevës, ka mbajtur një seancë solemne. Në këtë seancë, kryetari i Komunës së Malishevës, Ragip Begaj, i cili duke folur për ditën e çlirimit, përmendi sakrificën e popullit shqiptar dhe të Malishevës në veçanti, deri në formimin e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës dhe luftën e lavdishme të UÇK-së. Pasi foli për kontributin e Malishevës në luftën për liri, kryetari Begaj, bëri thirrje për angazhim të përbashkët në zhvillimin e shtetit dhe të komunës.

Ndërsa kryesuesi i KK të Malishevës, Aziz Thaçi, foli për luftën, heroizmin dhe sakrificën e luftëtarëve të UÇK-së, rëndësinë që Malisheva kishte në luftë, shpalljen e zonës së lirë në 1998 dhe për sakrificën e dëshmorëve, të cilët janë edhe krenaria jonë. Kryesuesi Thaçi, uroi që 16



Qershori, ti bashkoj të gjithë për punë dhe zhvillim, përderisa Malishevën e quajti shembullin më të mirë të zhvillimit të pasluftës.

Një fjalim rasti mbajti edhe Metush Kryeziu në emër të Shoqatës së Veteranëve të Luftës së UÇK-së, i cili ju uroi të gjithë qytetarëve të Malishevës, 16 Qershorin.

Më pas, janë bërë nderime pranë Shtatores së Komandantit Legjendar Adem Jashari në Malishevë, nderime para pllakës me emrat e martirëve të rënë gjatë luftës në Malishevë, dhe homazhe në varrezat e Dëshmorëve të Kombit në Malishevë dhe në Kleçkë. Aktivitetet kanë vazhduar me përrurimin e tri rrugëve, rrugën Malishevë-Carrallukë, rrugën në lagjen Mirëdita në Malishevë dhe rrugën Marali-Gajrak.

Në ora 13:00 është mbajtur programi artistik, si dhe janë ndarë çmimet tradicionale, të cilat i ndan Kuvendi i Komunës së Malishevës. Çmimin për trimëri dhe heroizëm “Imer Krasniqi” e morën Asallan Kastrati dhe Afrim Krasniqi, veteran të luftës, çmimin për kontribut në shkollën shqipe “Hamdi Berisha” e morën mësuesja veterane Xhezide Krasniqi dhe mësuesi veteran Idriz Hoxha, dhe çmimi për kontribut në shëndetësi “Dr.Shpëtim Robaj”, ju nda Fatmir Krasniqit (post mortum) dhe sektorit të urgjencës në QKMF në Malishevë.

Pas këtij koncerti, nën praninë e shumë qytetarëve, është përruar edhe memoriali kushtuar UÇK-së, ku nën antonimin e himnit kombëtar është ngritur një flamur gjigant në kodrën mbi Malishevë, si dhe janë punuar shkronjat UÇK. Në këtë memorial është bërë edhe zbulimi i pllakës ku është shkruar betimi i ushtarit të UÇK-së.

Gjatë paradites së sotme, është shfaqur edhe program për fëmijë.

Aktivitetet e sotme, përmyllen me një koncert të madh në parkun e qytetit.

Në vazhdimi fjalimi i kryetarit Ragip Begaj, me rastin e shënimit të 16 Qershorit.

Sot 17 vite më parë, Malisheva me vendbanimet e saja, përfundimisht u çlirua nga okupatori, për ta fituar lirinë e saj dhe për ta ndërtuar vendin.

Gjenerata të tëra, u munduan e u sakrifkuan, shumë prej tyre humbën gjymtyrët, shumë u burgosën e u torturuan, luftuan e u vranë. Vendi ynë, deri në vitin 1999, ishte i pushtuar nga pushtues të ndryshëm, në kohë të ndryshme. Por pushtimi i fundit nga sllavët, ishte më i rëndi për ne. Me vite të tëra u ushtrua dhunë mbi qytetarët tanë. U bë një gjenocid i paparë. Na u mohua çdo gjë për jetë. Përderisa bota ecte përpara e zhvillohej, e bashkë me zhvillimin ekonomik zhvillohej edhe demokracia dhe të drejtat e njeriut, popullit shqiptar në Kosovë, e posaçërisht në Malishevë, të gjitha këto të drejta ju mohuan, duke filluar me zhvillim ekonomik,



për të vazhduar me mohimin e të drejtave elementare të njeriut, ndërsa për demokraci as që bëhej fjalë.

Por këtyre vuajtjeve, ju kishte ardhur fundi. Shumë gjenerata u munduan përmes lëvizjeve dhe organizimeve të ndryshme, ta luftonin këtë sistem, që neve na i mohoi të gjitha. Në fund, u deshtë të bëhej një organizim i ri, që do ta luftonte pushtuesin në të gjitha frontet dhe në të njëjtën kohë të merrte përkrahjen e popullit dhe bashkësisë ndërkombëtare për ta zhvilluar këtë luftë. E ky organizim ishte Ushtria Çlirimtare e Kosovës, me në krye Komandantin legjendar Adem Jashari.

Malisheva, me të gjitha forcat, në të gjitha format dhe me tërë fuqinë e saj, ju bashkua Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Malisheva ju bashkua kushtrimin të Adem Jasharit dhe filloi organizimin dhe luftën e saj për liri, krahas të gjitha rajoneve tjera të Kosovës.

Në këtë luftë Malisheva kishte një rol të rëndësishëm, pasi duke qenë në qendër të Kosovës, ishte ura lidhëse e të gjithë luftës, por në të njëjtën kohë, ishim të vetëdijshëm se do të ishim edhe në qendër të sulmeve të pushtuesit, ashtu sikur kemi qenë gjithmonë.

Mijëra djem e vajza, ju bashkuan luftës çlirimtare. Çdo shtëpi e çdo banor i Komunës së Malishevës, ju bashkua luftës, duke dhënë kontributin e tyre, dikush me armë, dikush me furnizime, dikush me bukë. Malisheva u bë një strehë edhe për shumë banorë të Kosovës, të cilët ishin detyruar ti lëshonin shtëpitë e tyre. Malet e Berishës, Lugina e Pagarushës, Malet e Turjakës, u bënë shtëpi për qindramijëra banorë.

Lufta e Malishevës me rrethinë, u bë edhe qendër e zhvillimeve ushtarake dhe diplomatike. Këtu u vendos Shtabi i Përgjithshëm i UÇK-së, këtu u hapën zyra diplomatike, siç ishin Zyra e Misionit Diplomatik Amerikan në Kosovë dhe Misioni i OSBE-së në Kosovë. Këtu u hapën edhe qendrat informacionit dhe lidhjes me botën, duke u hapur radio e parë “Radio Kosova e lirë”, këtu filloj punën edhe agjencia e parë informative “Kosovapress”. Të gjitha këto erdhën si rezultat i luftës dhe trimërisë së burrave e burmeshave të Komunës së Malishevës.

Sot 18 vite më parë, ra heroikisht edhe dëshmori i parë në Komunën e Malishevës, Imer Krasniqi. Po sot 17 vite më parë, ra edhe dëshmori i fundit i Malishevës, Mentor Gashi. Ata ranë për të mos vdekur kurrë, bashkë me dëshmorët tjerë të Komunës së Malishevës, në luftën për liri.

Kjo ditë është dhuratë nga zoti për ne.

Ditë e Dëshmorëve dhe Ditë e Çlirimit të Malishevës.

Po sot, 17 vite më parë, Malisheva dhe vendbanimet e saja, u çliruan përfundimisht, për të jetuar të lirë, në tokën dhe shtëpitë e tyre.



Këta dëshmorë që ranë për lirinë që sot ne gëzojmë. Këto gjymtyrë që humbën djemtë e vajzat më të mira të Malishevës. Këta qindra të vrarë. Këta dhjetëra qytetarë, që edhe sot janë të zhdukur. Ky mund, e kjo sakrificë e veteranëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Mundi i baballarëve, i nënave, i vëllezërve dhe motrave tona, na obligon të gjithë neve, jo vetëm si institucione, por si popull, të punojmë në zhvillimin e vendit.

Malisheva ka dalë nga kjo luftë, më shumë se 90 për qind e shkatërruar dhe pa trashëguar asgjë, në infrastrukturë, nga e kaluara. Por sot Malisheva i ka të ndërtuara shumicën dërmuese të rrugëve, pothuajse me infrastrukturë rrugore më të mirën nga komunat tjera, ka ndërtuar sisteme të kanalizimeve dhe të ujësjellësve. Ka përmirësuar jetën e qytetarëve në të gjitha fushat.

Të nderuar qytetarë të Komunës së Malishevës,

Të nderuar të pranishëm,

Të nderuar mysafir,

Mbi të gjitha, Komuna e Malishevës, ka ndërtuar apo është në ndërtim e sipër të të gjitha objekteve shkollore duke u bërë komuna me infrastrukturën më të mirë shkollore, edhe pse kemi ende nevojë të investojmë në arsim. Investimi në arsim, është investim në të ardhmen tonë, prandaj, krahas investimeve në mirëqenien e qytetarëve, prioritet mbi prioritete do të mbetet investimi në arsim.

Unë, sot në 17 vjetorin e Çlirimit të Malishevës, ju ftoj të gjithëve që të punojmë së bashku, ta ndërtojmë komunën tonë së bashku dhe të luftojmë çdo të keqe që mund të prekë shoqërinë tonë. Lufta e bërë, gjaku i derdhur, vuajtjet e popullit tonë, janë bërë për shtetin, për kombin, prandaj, ne të gjallët e asaj lufte, duhet të punojmë për ardhmërinë e brezave që ne po lëmë pas, për ardhmërinë e fëmijëve tanë, për komunën tonë, por shtetin dhe kombin tonë.

Të nderuar të pranishëm,

E falënderoj zotin, që na i dhuroj dëshmorët, na e dhuroi lirinë, i dha jetë këtij vendi, Malishevës dhe Kosovës.

Më lejoni që në fund, në këtë ditë të shenjtë, t'i uroj të gjithë qytetarët e Komunës së Malishevës, me rastin e Ditës së Çlirimit.

Ju familje të Dëshmorëve, qëndroni krenarë. Krenare është Malisheva dhe kombi, me ju.



Urime Dita e Çlirimit.

Lavdi të gjithë dëshmorëve të kombit.

Filloi asfaltimi i rrugës në lagjen e Hotëve

Malishevë, 20 qershor



Në kuadër të asfaltimit të rrugëve dhe rregullimit të infrastrukturës së përgjithshme në qytetin e Malishevës, sot ka hyrë në fazën finale rruga në lagjen e Hotëve. Pas zgjerimit dhe rregullimit të bazës, sot ka filluar asfaltimi i kësaj rruge. Asfaltimin e rrugës e kanë përcjellë nga afër, i pari i Malishevës, Ragip Begaj, së bashku me drejtorin e urbanizmit Ahmet Morina dhe atë të administratës, Hajrullah Mazreku.

Me këtë rast, kryetari Begaj i ka uruara banorët e kësaj lagjeje, përkatësisht të atyre që jetojnë përgjatë kësaj rruge, dhe tha se “janë të përkushtuar në rregullimin e përgjithshëm, të infrastrukturës në tërë territorin e Komunës së Malishevës, ndërsa qyteti, dot të vazhdoj të ketë vëmendje të veçantë”.

Drejtori i urbanizmit Ahmet Morina, tha se “kjo rrugë, përveç rëndësisë që ka për vet banorët e kësaj lagjeje, është edhe një lloj mini transiti, pasi një pjesë e madhe e ngasësve të veturave, nuk kanë nevojë të hyjnë nëpër qytet, por mund ta shfrytëzojnë këtë rrugë”.

Rruga në lagjen e Hotëve, fillon nga hyrja në qytet, përkatësisht rruga Malishevë-Prishtinë, në pjesë veriore dhe lidhet me pjesë perëndimore, apo në rrugën Malishevë-Kijevë-Pejë, prandaj edhe shërben si transit për ngasësit e veturave, që lëvizin në këto dy rrugë, në mënyrë që ti ikin tollovisë në qytet, sidomos gjatë sezonit të verës, kur rrugët janë tejet të ngarkuara.



KPF shqyrtoi kornizën afatmesme buxhetore 2017-2019

Malishevë, 21 qershor

Komiteti për Politikë dhe Financa (KPF), i drejtuar nga kryesuesi i Kuvendit të Komunës së Malishevës, Aziz Thaçi, ka mbajtur sot mbledhjen e gjashtë me radhë për këtë vit, ndërsa pikë e rëndësishme e mbledhjes së sotme ishte korniza afatmesme buxhetore 2017-2019, me theks të veçantë buxheti për vitin 2017, pikë të cilën e rekomanduan për shqyrtim në mbledhjen e ardhshme të Kuvendit të Komunës.

Kornizën afatmesme buxhetore, para anëtarëve të KPF-së, e ka prezantuar drejtori i Drejtorisë për Ekonomi, Buxhet dhe Financa, Vesel Krasniqi, i cili edhe ka shprehur pakënaqësinë e tij dhe të drejtorisë që drejton, lidhur me qarkoren e parë buxhetore, e cila sipas Krasniqit, është jo profesionale, është dërguar me vonesë, jashtë afateve ligjore dhe mbi të gjitha ka defekte të mëdha, të cilat do të ndikojnë direkt në buxhetin komunal për vitin 2017.

Drejtori Krasniqi, ka thënë para anëtarëve të KPF-së, se “qarkoren që do ta dërgojnë në ministrinë përkatëse, e kanë hartuar në bazë në mundësive dhe nevojave të komunës dhe jo ashtu siç është hartuar nga ana e ministrisë, me shumë defekte”. Po ashtu Krasniqi, deklaroi se për të gjitha vërejtjet, me shkrim dhe në kohë e kanë informuar ministrinë.

Edhe anëtarët e KPF-së, pas shqyrtimit kanë vërejtur defekte të mëdha në qarkoren e parë buxhetore, të dërguara nga ana e ministrisë, pasi aty është rritur punëtorëve në arsim, pastaj shuma e të hyrave vetanake, është jashtë çdo mundësie të realizohet, sikur edhe defekte tjera, të cilat natyrshëm do të ndikojnë negativisht në qarkoren e dytë buxhetore.

Anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa, e kanë rekomanduar për shqyrtim në Kuvendin e Komunës, kornizën afatmesme buxhetore dhe në të njëjtën kohë, e kanë përkrahur drejtorinë në hartimin e kornizës buxhetore, në bazë të nevojave dhe mundësive që ka Komuna e Malishevës.



Filloi rregullimi edhe i një rruge në Malishevë

Malishevë, 21 qershor

Në kuadër të rregullimit të infrastrukturës në qytetin e Malishevës, përkatësisht në lagjet e qytetit, pas rregullimit të dy kanalizimeve dhe disa rrugëve, sot ka filluar rregullimi edhe i një rruge në lagjen e Gurit, pasi paraprakisht në atë pjesë ka përfunduar rregullimi i kanalizimit. Rruga është e gjatë afër 400 metra, dhe është një prej projekteve të planifikuara nga qeveria komunale.

Fillimin e punimeve e kanë parë nga afër edhe kryetari i Komunës së Malishevës, Ragip Begaj, bashkë me drejtorin e urbanizmit Ahmet Morina dhe atë të administratës, Hajrullah Mazreku. Kryetari Begaj dhe drejtorët, i kanë uruar banorët për fillimin e punimeve dhe i kanë siguruar banorët, se janë të përkushtuar në rregullimin infrastrukturës dhe projekteve, përmes së cilave, rritet mirëqenia e qytetarëve, në rastin konkret, banorët e kësaj pjesë, nuk do të kenë problem në qarkullimin e tyre, deri në rrugët kryesore të qytetit.

Ndërsa drejtori i urbanizmit Ahmet Morina, ka sqaruar se rruga e gjatë afër 400 metra, ndërtohet me fonde të komunës, ndërsa rruga do të jetë e shtruar me kubëza, e jo me asfalt, pasi është një zonë ku mund të ketë punime tjera, dhe rruga nuk dëmtohet gjatë punimeve në të ardhmen dhe se kubëzat janë praktik.

Inspektorati kontrollon marketet për afat të skadimit të gjërave ushqimore

Malishevë, 23 qershor

Zyrtarët e Drejtorisë së Inspektoratit në Komunën e Malishevës, ditëve të fundit, kanë ndërmarrë një aksion kontrolli në të gjitha marketet e mëdha dhe të vogla, me qëllim të kontrollimit të afatit



të përdorimit, kryesisht të gjërave ushqimore. Gjatë këtyre kontrolleve, është hasur në sasi jo të mëdha të artikujve me afat të skaduar, kurse malli i konfiskuar është asgjësuar.

Sipas Bardhyl Buçajt, shëf në drejtorinë e inspektoratit, “aksioni është kryer në të gjitha marketet dhe supermarketet në Malishevë, dhe me këtë rast është hasur në mall me afat të skaduar, në vlerë 162 euro, kurse malli i konfiskuar, është asgjësuar”.

Buçaj, ka paralajmëruar vazhdimin e aksionit, në të gjitha marketet dhe dyqanet, në të gjitha fshatrat e Komunës së Malishevës. “Qëllimi i këtij aksioni, është mbrojtja e qytetarëve nga konsumimi i mundshëm i gjërave ushqimore, të cilave ju ka skaduar afati”, tha Buçaj.

Me këtë rast, Drejtoria e Inspektoratit në Malishevë, ju bën thirrje të gjithë qytetarëve, që nëse hasin në mall me afat të skaduar, qoftë ushqimore, qoftë mall tjetër, që të lajmërojnë inspektoratin komunal.

Humanisti Kryeziu, investoi në rregullimin e ujit për QMF-në në Pagarushë

Malishevë, 24 qershor



Humanisti Skënder Kryeziu nga Pagarusha e Malishevës, në kuadër të aktiviteteve të tij humanitare, është duke e rregulluar sistemin e ujit për Qendrën e Mjekësisë Familjare (QMF) në Pagarushë. Për këtë qëllim, sot këtë QMF e ka vizituar edhe drejtori i shëndetësisë, Hajdin Berisha, i cili e ka falënderuar donatorin për këtë vepër të tij, krahas shumë veprave tjera.

Uji në QMF të Pagarushës, ka pasur probleme në funksionim, prandaj, ky humanist, ka vendosur që të investoj në sigurimin e ujit, duke siguruar burimin, shtrirjen e gypit dhe futjen e ujit brenda objektit të kësaj qendre të mjekësisë.

“Në emër të drejtorisë për shëndetësi dhe mirëqenie sociale, e falënderoj donatorin, përkatësisht humanistin Skënder Kryeziu për këtë ndihmë në QMF në Pagarushë, si dhe për ndihmat tjera që i ka bërë dhe po i bën në vazhdimësi”, tha drejtori Berisha.



Skënder Kryeziu, apo siç e njohin në opinion si Skënder Pagarusha, është prej humanistëve, që në vitet e fundit, në vazhdimësi po i ndihmon familjet me gjendje të rëndë sociale, anekënd Kosovës, si në ndërtim të shtëpive, ashtu edhe në sigurimin e nevojave elementare për jetë. Përveç këtyre familjeve, ky humanist, në vazhdimësi ka ndihmuar edhe spitalet dhe entet tjera shëndetësore, kurse sigurimi i ujit për QMF-në në Pagarushë, është njëra prej veprave të tij humanitare.

Komuna e gatshme për fushatën e korrje shirjeve

Malishevë, 27 qershor

Sot është mbajtur mbledhja e rregullt e Këshillit të Drejtorëve, që drejtohet nga kryetari i Komunës së Malishevës, Ragip Begaj, ndërsa në këtë mbledhje, drejtori për bujqësi, Haxhi Krasniqi, ka deklaruar se kjo drejtori është bërë gati për fillimin e sezonit të korrje shirjeve në Komunën e Malishevës.

“Jemi bërë gati si drejtori për fillimin e sezonit të korrje shirjeve, i kemi bërë të gjitha përgatitjet si dhe kemi formuar shtabin komunal, që do ta mbikëqyr tërë fushatën e korrje shirjeve”, ka thënë drejtori Krasniqi, në mbledhjen e sotme të qeverisë komunale.

Po ashtu në këtë mbledhje janë diskutuar edhe çështje tjera, ndërsa drejtorja e shërbimeve publike, ka bërë të ditur se kanë filluar bëhen kërkesa nga ana e qytetarëve për ujë për pije. “Temperaturat e larta, kanë bërë që qytetarët të kërkojnë të furnizohen me ujë për pije”, u tha nga përgjegjësit e kësaj drejtorie.

Kurse sa i përket gjendjes epidemiologjike, u rikonfirmua se nuk ka raste të infektimit me EHKK, ndërsa ka përfunduar cikli i tretë i repelimit të kafshëve dhe faza e dytë e dezinsketimit të zonave të cilësuaru endemike.



Malisheva vazhdon të mbetet komunë e sigurt

Malishevë, 28 qershor



Situata e sigurisë së përgjithshme në Komunën e Malishevës, vazhdon të mbetet e mirë, e qetë dhe pa tendencë të prishjes së kësaj situatë. Kështu u vlerësua në mbledhjen e tretë të Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi (KKSB), të cilën e udhëhoqi nënkryetari i Komunës së Malishevës, Rexhep Mazreku, i cili edhe i falënderoi të gjithë, për ruajtjen e kësaj situatë.

“Bazuar në informacionet zyrtare, situata e sigurisë së përgjithshme në Komunën e Malishevës, është e qetë dhe stabile, si në fushën e krimit, ashtu edhe në atë të etheve hemorragjike dhe të zjarreve”, tha nënkryetari Mazreku.

Edhe komandanti i stacionit policor në Malishevës, kapiteni Halil Morina, e ka konfirmuar se situata është e qetë stabile dhe pa tendencë të prishjes së situatës së përgjithshme të sigurisë. “Kësaj i shtohet edhe fakti, se ka rënie të dukshme të rasteve kriminale, në vazhdimësi. Në këtë tremujor, ka rënie të rasteve kriminale për dymbëdhjetë për qind, në raport me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar”, deklaroi kapiteni Morina.

Kurse drejtori i Drejtorisë për Mbrojtje dhe Shpëtim, Sejdi Paçarizi, duke folur për situatën epidemiologjike, tha se “situata është në kontroll dhe nuk ka asnjë rast të regjistruar me ethe hemorragjike krime kongo”, kurse sa i përket zjarreve, ai tha se ka raste të rralla të zjarreve, kryesisht fushore, por pa ndonjë rrezik për përhapje të zjarreve.

Edhe drejtori i arsimit, Avdi Morina, duke folur për përfundimin e vitit shkollor, tha se situata e sigurisë në shkolla është e mirë, si në objekte, ashtu edhe në procesin mësimor, brenda hapësirave në shkolla, kurse sipas tij, për rritur edhe më shumë sigurinë, do të ishte mirë, që në të ardhmen të vendosen edhe kamerat e sigurisë.



Ministria e Diasporës dhe Komuna e Malishevës, bëjnë thirrje për regjistrimin e bashkatdhetarëve

Malishevë, 29 qershor



Kryetari i Komunës së Malishevës, Ragip Begaj, ka pritur sot në një takim pune, zëvendësministrin e Ministrisë së Diasporës në Qeverinë e Republikës së Kosovës, Janez Frrokaj, me të cilin kanë biseduar për bashkatdhetarët dhe angazhimet e përbashkëta për regjistrimin e të gjithë bashkatdhetarëve, që vijnë në gjatë kësaj sezone në vend.

Zv/ministri Frrokaj dhe kryetari Begaj , ju bëjnë thirrje të gjithë atyre bashkatdhetarëve, që vijnë për pushime gjatë verës, që të paraqiten dhe të regjistrohen. Qëllimi i këtij regjistrimi është sigurimi i statistikave për numrin e bashkatdhetarëve tanë që jetojnë në vende tjera.

Për këtë regjistrimin, ministria ka paraparë, angazhimin e zyrtarëve, pranë komunës, në mënyrë që të jetë më i lehtë paraqitja dhe regjistrimi i bashkatdhetarëve, ndërsa komuna do të siguroj hapësirat e nevojshme, për kryerjen e këtij procesi.

Po ashtu, Begaj dhe Frrokaj, kanë biseduar edhe për organizimin e ditëve të diasporës, ku kryetari Begaj e ka njoftuar me aktivitetet e parapara nga ana e Komunës së Malishevës, në veçanti për festivalin “Oda e Llapushës”, që organizohet në kuadër të ditëve të diasporës.



KK i Malishevës, miratoi Kornizën Afatemesme Buxhetore

Malishevë, 30 qershor



Kuvendi i Komunës së Malishevës, nën drejtimin e kryesuesit Aziz Thaçi, ka mbajtur sot mbledhjen e gjashtë të rregullt. Në mesin e shumë shqyrtimeve dhe marrjes së disa vendimeve, KK i Malishevës, ka miratuar edhe Kornizën Afatemesme Buxhetore 2017-2019, me disa propozime të dhëna nga ana e anëtarëve të kuvendit.

Kornizën Afatemesme Buxhetore, para anëtarëve të kuvendit, e ka prezantuar

drejtori për buxhet dhe financa, Vesel Krasniqi, i cili po ashtu i ka njoftuar edhe me disa defekte nga ana e ministrisë përkatëse, që e kanë përcjellë qarkoren e parë buxhetore. Po ashtu drejtori Krasniqi, ka raportuar para kuvendit edhe për të hyrat dhe shpenzimet në tre mujorin parë të këtij viti.

KK i Malishevës, po ashtu ka marrë vendim edhe për miratimin e kërkesës së një qytetari për ndërrim destinim të tokës bujqësore në tokë ndërtimore.

Në rend dite të mbledhjes së sotme, ishte edhe shqyrtimi i raportit të komisionit për ndarjen e bursave, raport të cilin e prezantoi nënkryetari i Komunës së Malishevës, Rexhep Mazreku. Anëtarët e KK të Malishevës, dhanë disa vërejtje për ndarjen e bursave, mirëpo nënkryetari Mazreku, ka sqaruar se bursat janë ndarë me rregulloren e vjetër, pasi rregullorja e re, ende nuk është kthyer nga ministria përkatëse dhe rrjedhimisht nuk ka qenë e mundur të futet në funksion.

Përndryshe, mbledhjen e sotme të KK-së, e kanë lëshuar anëtarët e PDK-së, pasi siç u tha, do të presin sqarimet e organeve përkatëse, lidhur me çështjen e fotografisë së presidentit të vendit dhe deri atëherë do ta bojkotojnë punën e kuvendit. Lidhur me këtë çështje, kryesues Aziz Thaçi, i ka njoftuar anëtarët e kuvendit, se zyrtarisht ka kërkuar interpretim, lidhur me çështjen se “a duhet të vendoset në sallën e mbledhjeve të Kuvendit të Komunës fotografia e presidentit apo jo”.